

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____ 2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10352, DATË 18.11.2010
“PËR ARTIN DHE KULTURËN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave:

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

Pas fjalës “...subjekteve” shtohet “publike dhe private...”

Neni 2

Neni 4 pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si vijon:

“4. Institucion publik i artit dhe kulturës është struktura e krijuar me ligj, Vendim të Këshillit të Ministrave ose Vendim të Këshillit Bashkiak, e cila ka në objektin e veprimtarisë së saj përhapjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohen nenet 4/1 dhe neni 4/2 me përmbajtje si më poshtë vijon :

“Neni 4/1

Politikat në fushën e artit dhe kulturës

1. *Politikat në fushën e artit dhe kulturës drejtohen dhe mbështeten nga Këshilli i Ministrave.*
2. *Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën zbaton politikën për mbrojtjen dhe promovimin e artit dhe kulturës, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e saj në respektim të dispozitave të këtij ligji.*
3. *Strategjia kombëtare për zhvillimin e artit dhe kulturës, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.*

Neni 4/2

Prioritetet e Ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën

1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën mbështet nismat kulturore dhe projektet krijuese nëpërmjet:

- a) zhvillimit të bashkëpunimit kulturor me njësitë e qeverisjes vendore si dhe organizatat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- b) dhënies së informacionit si dhe krijimit të mundësive për pjesëmarrjen në programet ndërkombëtare.
- c) zhvillimit të instrumenteve rregullatorë në fushën e artit dhe kulturës.
- ç) financimit të plotë ose të pjesshëm për institucionet publike qendrore, vendore ose të pavarura si dhe subjekteve private të artit dhe kulturës.
- d) hartimin e programeve dhe aktiviteteve artistike me fokus edukimin përmes kulturës.

Neni 4

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 pas fjalës “..qendrore” shtohet togfjalëshi “në varësi të Ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën...”.
2. Në germën d, të pikës 3, togfjalëshi “Galeria Kombëtare e Arteve” zëvendësohet me togfjalëshin “Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura”.
3. Pas germës “e” shtohen germat “ë”, “f”, “g”, “gj” si më poshtë:
 - ë) Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit;
 - f) Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit
 - g) Biblioteka Kombëtare;
 - gj) Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale.

Neni 5

Në germën c) të nenit 11 në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “...dhe efektet financiare sipas propozimeve nga sektorët artistikë dhe strukturës financiare në institucionin përkatës;”.

Neni 6

Në kreun V bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në titull pas togfjalëshit “..MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR ARTIN DHE KULTURËN” shtohet “..DHE INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE TË ARTIT DHE KULTURËS”.

Neni 7

Në nenin 26 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Fjalja e parë e pikës 1 të nenit 26 riformulohet si më poshtë:

“1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe institucionet qendrore publike të artit dhe kulturës, financojnë nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit.”
2. Pas germës “b” shtohet germa “c” me përmbajtje si më poshtë:

"c) projekte të hartuara nga vetë Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës.

Neni 8

Në nenin 27 bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në titull pas fjalës "...kulturore" shtohet *"nga Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën"*.

Neni 9

Në nenin 27/1 bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në titull pas fjalës "...kolegjiumit" shtohet *"në Ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën"*.
2. Në pikën 1 germa b) riformulohet si vijon:
"nxit dhe i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të këtij ligji.
3. në pikën 1 germa c) pas fjalëve "...në gjini të ndryshme të artit" shtohet *"dhe kulturës."*

Neni 10

Pas nenit 27/1 shtohet neni 27/2 me përmbajtje si më poshtë:

"Neni 27/2

Realizimi i veprimtarive artistiko-kulturore në institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës

1. *Realizimi i veprimtarive artistiko-kulturore në institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, miratohen me Urdhër të titullarit pas propozimit nga kolegjiumi i institucionit përkatës, bazuar në vendimin e Bordit Artistik sipas nenit 11 të këtij ligji.*
2. *Kolegjiumi ka në përbërje jo më pak se 3 nëpunës ose punonjës të përcaktuar me urdhër të titullarit. Anëtarët e kolegjiumit janë punonjës të institucionit ose personalitete të fushës.*
3. *Kompetencat dhe mënyrat e funksionimit të kolegjiumit për institucionet qendrore të artit dhe kulturës miratohen nga Titullari i institucionit.*

Neni 11

Në nenin 29 bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në germën c) togfjalëshi *"Qendrën Kombëtare të Artit dhe Kulturës"* zëvendësohet me *"Ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën"*

Neni 12

Në Kreun VIII Titulli ndryshohet si më poshtë :

“MARRËDHËNIET KONTRAKTUALE NË VEPRIMTARITË E ARTIT DHE TË KULTURËS”

Neni 13

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34

Marrëdhëniet financiare me artistët

Marrëdhëniet financiare për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike me artistin jashtë sistemit të institucioneve publike të artit dhe kulturës rregullohen me kontratën e lidhur mes artistit dhe institucionit publik financues nëpërmjet negocimit.”.

Neni 14

Shfuqizime

1. Numri “34” në pikën 1 të nenit 35 “Dispozita Kalimtare të fundit” shfuqizohet.
2. Aktet që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10352, DATË 18.11.2010 "PËR ARTIN DHE KULTURËN", TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Projektakti që ju paraqesim për mendim ka për qëllim miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", të ndryshuar". Këto shtesa dhe ndryshime të sjella vijnë si rezultat i disa faktorëve të ndryshëm që në përfundim kanë një qëllim që është zhvillimi i mëtejshëm i artit dhe kulturës nga skena e pavarur me mbështetjen e institucioneve publike qendrore dhe vendore.

Në këtë projektligj përcaktohen për herë të parë dispozita lidhur me politikën në fushën e artit dhe kulturës si dhe prioritetet e ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën ku përfshihen politika për mbrojtjen dhe promovimin e artit dhe kulturës, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e saj në respektim të dispozitave të këtij ligji si dhe parashikimeve ligjore të strategjisë kombëtare për zhvillimin e artit dhe kulturës, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

Në kuadër të Konsultimit publik paraprak, Ministria e Kulturës dhe Skena e Pavarur Kulturore nënshkruan memorandumimin e bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës dhe Skenës së Pavarur Kulturore" për bashkëpunimin dhe konsultimin paraprak për ndryshimet në ligjin "Për Artin dhe Kulturën". Ky memorandum është hapi i parë juridik për të zhvilluar dhe forcuar mekanizmat në zhvillim të kulturës. Në vijim të politikave të MK-së për të nxitur krijimtarinë përmes thirrjeve të hapura, krijim i një sistemi të qëndrueshëm e transparent i shpërndarjes së fondeve, politika për të rritur cilësinë artistike, garantim e respektim i të drejtës së autorit, etj., Ministria e Kulturës nënshkroi me SPK-në një Memorandum Bashkëpunimi përmes të cilit, të dyja palët do të angazhohen në hartimin e një kuadri ligjor me qëllim një reformë të plotë të Artit dhe të Kulturës të bazuar mbi Strategjinë Kombëtare të Kulturës që është duke përfunduar në bashkëpunim me ekspertë të Këshillit të Europës. Përfshirja e ekspertëve vendas dhe të huaj në draftimin e ligjit do të ndihmojë për ta bërë ligjin më të qëndrueshëm dhe më afër standardeve evropiane.

Memorandumi i Bashkëpunimit u nënshkrua nga zv. Ministrija e Kulturës, znj. Valbona Shujaku dhe Andi Tepelena, përfaqësues i SPK-së. Skena e Pavarur Kulturore (SPK) është RRJETI më i madh kulturor në Shqipëri, i përberë nga organizatat ndër më të njohurat dhe aktivet në fushën e artit dhe kulturës. SPK është krijuar më 4 Maj 2013. Qëllimi i këtij RRJETI është të ndërtojë një skenë kulturore të qëndrueshme, nisur nga mungesa e faciliteteve për veprimtaritë kulturore e artistike, mosfinancimi dhe pabarazia e aksesit ndaj fondeve publike për artin dhe kulturën në Shqipëri.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ministria e Kulturës është angazhuar në përgatitjen e këtij projektligji, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare të artit dhe kulturës, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë .

Po kështu, projektligji është në përputhje me programin analitik të projektakteve të miratuara për Ministrinë e Kulturës, i cili është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 24.1.2018, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 31 janar 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

1. Financimi i Projekteve dhe Veprimtarive Artistike

Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", i ndryshuar, përcakton se Ministria e Kulturës i zhvillon aktivitetet artistike në përjashtim të prokurimit publik sipas parashikimeve të këtij ligji. Gjatë zbatimit ndër vite është konstatuar se në fakt përveç Ministrisë së Kulturës janë edhe institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës ato të cilat kanë më së shumti nevojë të zhvillojnë të njëjtat procedura në përjashtim të prokurimit publik, duke sjellë në vëmendje se produkti kryesor final i veprimtarisë së tyre është cilësia artistike e këtyre aktiviteve.

Mungesa e një parashikimi të tillë në projektligjin aktual ka sjellë problematika të shumta pasi parashikimet e prokurimit publik në të shumtën e rasteve nuk janë adapte për një fushë kaq specifike sa është veprimtaria artistike dhe kulturore, duke krijuar burokraci dhe pengesa në realizimin e aktiviteve të tyre. Në vijim të këtyre problematikave, në mënyrë të vazhdueshme institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës kanë kërkuar ndryshimin e ligjit për të t'u përfshirë edhe ato në parashikimet e financimit të projekteve artistike sipas ligjit të artit dhe kulturës.

Në vijim të kësaj në projektligj janë parashikuar disa dispozita lidhur me përfshirjen e subjekteve më sipër, në parashikimet e financimit të projekteve artistike sipas ligjit të artit dhe kulturës Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Biblioteka Kombëtare, Qendra Kombëtare Veprimtarive Tradicionale etj.

2. Cilësia Artistike

Një ndryshim i parashikuar në këtë projektligj është ai i marrëdhënieve financiare me artistët dhe cilësinë artistike. Në parashikimet e reja të propozuara nga Ministria e Kulturës, theksohet thelbi që marrëdhëniet financiare për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike me artistin e jashtë sistemit të institucioneve publike të artit dhe kulturës rregullohen me kontratën e lidhur mes artistit dhe institucionit publik financues.

Kjo bëhet për disa arsye të cilat lidhen specifikisht me fushën e artit dhe kulturës:

a) Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën nuk mund të vlerësojë suksesin që një artist ka ndaj një tjetri. Ajo bëhet nëpërmjet suksesit që një artist ka në publik si vlerësuesi real i talentit.

b) në shumë vepra artistike është regjisor i apo figura të tjera vlerësuese të cilët vlerësojnë talentin artistik dhe cilësinë e artistit i cili do të angazhohet në një vepër.

c) marrja përsipër nga ana e Ministrisë përgjegjëse e ngurtësimit të cilësisë artistike bazuar në burokracinë veçse do të pengonte zhvillimin natyral të fushës së artit dhe kulturës në Shqipëri.

3. Politikat dhe Prioritetet e Ministrisë Përgjegjëse për artin dhe kulturën

Në këtë projektligj përcaktohen për herë të parë dispozita lidhur me politikën në fushën e artit dhe kulturës si dhe prioritetet e ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën ku përfshihen politika për mbrojtjen dhe promovimin e artit dhe kulturës, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e saj në respektim të dispozitave të këtij ligji si dhe parashikimi ligjor se strategjia kombëtare për zhvillimin e artit dhe kulturës, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

4. Rregullime teknike

Gjithashtu në parashikimet e këtij projektligji janë vendosur edhe disa rregullime të dispozitave aktuale si:

- a) përkufizimi i institucionit publik të artit;
- b) Përfshirjen e dy institucioneve të reja si Muzeu i Arteve të Bukura, i cili zëvendëson Galerinë Kombëtare të Arteve (kjo bazuar në ligjin e ri të Trashëgimisë Kulturore dhe Muzeve) dhe Qendra Kombëtare e Letrave dhe Leximit, institucion i ri në fushën e librit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është bazuar në nenet 78, pika 1 e nenit 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe është iniciativë e Qeverisë së Shqipërisë në kuadër të zhvillimit të politikave në fushën e artit dhe kulturës. Projektligji i propozuar është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EUROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me Acquis e BE-së.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Në ligjin nr.10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

Pas fjalës "...subjekteve" shtohet "publike dhe private..."

SHPJEGIM: Amendimi për përfshirjen e subjekteve private, rregullon marrëdhëniet me subjekte individë, artistë krijues, interpretues, autorë, producentë etj., aplikues të ndryshëm, të cilët kryejnë dhe iniciojnë veprimtari kulturore artistike dhe hyjnë në marrëdhënie me institucionet e artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Neni 4 pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si vijon:

"4. Institucion publik i artit dhe kulturës është struktura e krijuar me ligj, Vendim të Këshillit të Ministrave ose Vendim të Këshillit Bashkiak, e cila ka në objektin e veprimtarisë së saj përhapjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore.

SHPJEGIM: Ky nen parashikon përkufizimin e Institucioneve publike të artit dhe kulturës, të krijuara me ligj, me Vendim të Këshillit të Ministrave apo Vendim të Këshillit Bashkiak, qofshin këto qendrore apo vendore, në varësi ose jo të MK. Nuk kemi të bëjmë me subjektet privatë.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohen neni 4/1 dhe neni 4/2 me përmbajtje si më poshtë vijon :

"Neni 4/1

Politikat në fushën e artit dhe kulturës

- 1. Politikat në fushën e artit dhe kulturës drejtohen dhe mbështeten nga Këshilli i Ministrave.*
- 2. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën zbaton politikën për mbrojtjen dhe promovimin e artit dhe kulturës, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e saj në respektim të dispozitave të këtij ligji.*
- 3. Strategjia kombëtare për zhvillimin e artit dhe kulturës, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.*

Neni 4/2

Prioritetet e Ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën

- 1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën mbështet nismat kulturore dhe projektet krijuese nëpërmjet:*
 - a) zhvillimit të bashkëpunimit kulturor me njësitë e qeverisjes vendore si dhe organizatat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.*
 - b) dhënies së informacionit si dhe krijimit të mundësive për pjesëmarrjen në programet ndërkombëtare.*
 - c) zhvillimit të instrumenteve rregullatorë në fushën e artit dhe kulturës.*
 - ç) financimit të plotë ose të pjesshëm për institucionet publike qendrore, vendore ose të pavarura si dhe subjekteve private të artit dhe kulturës.*
 - d) hartimin e programeve dhe aktiviteteve artistike me fokus edukimin përmes kulturës.*

SHPJEGIM: Në nenin 3 të projektligjit janë parashikuar të shtohen 2 nene të cilat përcaktojnë politikat në fushën e artit dhe kulturës ku përfshihet dhe Strategjia kombëtare për zhvillimin e artit dhe kulturës, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën. Ndërsa neni 4/2 parashikon bazën e nevojshme ligjore edhe në legjislacionin e brendshëm për të përcaktuar format e bashkëpunimit në fushën e kulturës, me qeverisjen vendore si dhe organizatat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe krijimit të mundësive për pjesëmarrjen në programet ndërkombëtare.

Neni 4

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- 1. Në pikën 2 pas fjalës "...qendrore" shtohet togfjalëshi "në varësi të Ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën..."*

2. Në germën d të pikës 3, togfjalëshi “Galeria Kombëtare e Arteve” zëvendësohet me togfjalëshin “Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura”.

3. Pas germës “e” shtohen germet “ë”, “f”, “g”, “gj” si më poshtë:

“ë) Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit;

f) Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit”

g) Biblioteka Kombëtare;

gj) Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale.

SHPJEGIM: Galeria Kombëtare, në kuadër të një rikonceptimi të plotë në përmbajtje, por edhe infrastrukturore, për sa kohë disponon fond kombëtar të rëndësisë së veçantë, do të kryejë dy funksione, atë të muzeut, që do të thotë fondet do të jenë të ekspozuara për publikun në linja të caktuara dhe njëkohësisht funksionin e zhvillimit të ekspozitave të përkohshme të autorëve të traditës dhe atyre bashkëkohorë. Ky ndryshim i emërtesës ka hyrë në fuqi me miratimin e ligjit të ri për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

Për sa i përket, listimit të disa institucioneve shtesë si BKSH, AQSHF, Qendra e Veprimtarive Tradicionale, deri më sot nuk kanë pasur hapësira për trajtimin dhe mbështetjen e projekteve me nisëm nga aktorë të fushës por edhe vet institucioneve. Ndaj përfshirja në këtë ligj do të jetë një instrument lehtësimi dhe mekanizëm çlirues për procedura të projekteve artistike kulturore.

Këto institucione do të vijojnë të mbështeten në kuadrin e tyre ligjor bazë përkatës me të cilin janë krijuar. Amendimet e këtij ligji, nuk shfuqizojnë ligjet përkatëse, në dispozitat e tyre ligjore aktuale, prandaj dhe nuk janë përfshirë në dispozitat tranzitore të këtij projektligji.

Neni 5

Në germën c) të nenit 11 në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “...dhe efektet financiare sipas propozimeve nga sektorët artistikë dhe strukturës financiare në institucionin përkatës;”.

SHPJEGIM: Në detyrat funksionale të bordit artistik që funksionon pranë institucionit qendror publik të artit dhe kulturës qartësohen kompetencat e bordit duke shtuar që miratimi i projekteve artistike sipas repertorit bazuar në propozimet e sektorëve artistikë dhe strukturës financiare në institucionin përkatës, duke sjellë koordinim më të mirë të punës ndërmjet këtyre sektorëve.

Neni 6

Në kreun V bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në titull pas togfjalëshit “..MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR ARTIN DHE KULTURËN” shtohet “..DHE INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE TË ARTIT DHE KULTURËS”.

Neni 7

Në nenin 26 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Fjalja e parë e pikës 1 të nenit 26 riformulohet si më poshtë:
“1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe institucionet qendrore publike të artit dhe kulturës, financojnë nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit.”
2. Pas germës “b” shtohet germa “c” me përmbajtje si më poshtë:

~~“c) projekte të hartuara nga vetë Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës.~~

SHPJEGIM: Në nenin 6 dhe 7 të projektligjit është bërë një saktësim teknik në mënyrë që institucionet publike të artit dhe kulturës të përfshihen në skemën e procedurës nëpërmjet kolegjiut, si dhe realizimit të procedurave të projekteve artistike jashtë ligjit të prokurimit publik. Po kështu është shtuar një pikë që Ministria vetë për projektet e saj të ndjekë të njëjtën linjë edhe në funksion të unifikimit të procedurave në art dhe kulturë.

Neni 8

Në nenin 27 bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në titull pas fjalës “...kulturore” shtohet “nga Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën”.

Neni 9

Në nenin 27/1 bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në titull pas fjalës “...kolegjiut” shtohet “në Ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën”.
2. Në pikën 1 germa b) riformulohet si vijon:
“nxit dhe i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të këtij ligji.
3. në pikën 1 germa c) pas fjalëve “...në gjini të ndryshme të artit” shtohet “dhe kulturës.”.

Neni 10

Pas nenit 27/1 shtohet neni 27/2 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 27/2

Realizimi i veprimtarive artistiko-kulturore në institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës

1. *Realizimi i veprimtarive artistiko-kulturore në institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, miratohen me Urdhër të titullarit pas propozimit nga kolegjiut i institucionit përkatës, bazuar në vendimin e Bordit Artistik sipas nenit 11 të këtij ligji.*
2. *Kolegjiut ka në përbërje jo më pak se 3 nëpunës ose punonjës të përcaktuar me urdhër të titullarit. Anëtarët e kolegjiut janë punonjës të institucionit ose personalitete të fushës.*
3. *Kompetencat dhe mënyrat e funksionimit të kolegjiut për institucionet qendrore të artit dhe kulturës miratohen nga Titullari i institucionit.*

SHPJEGIME: Në nenin 27 dhe 27/1 janë bërë saktësimet duke i kanalizuar këto procedura vetëm për ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën në mënyrë që të mos krijohet konfuzion me procedurën që duhet të ndiqet nga institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës të parashikuara në nenin 27/2.

Në nenin 27/2 është parashikuar ngritja e kolegjiut si procedurë lidhur me realizimin e aktiviteteve kulturore duke respektuar tagrat dhe kompetencat e Bordit Artistik të institucioneve të artit dhe kulturës, ku del qartësisht që Bordi Artistik është organi kolegjal

vendimmarrës për miratimin e projekteve/aktiviteteve ndërsa kolegji i institucioneve të artit dhe kulturës zbatojnë procedurën për realizimin e këtyre projekteve/aktiviteteve.

Neni 11

Në nenin 29 bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në germen c) togfjalëshi “..*Qendrën Kombëtare të Artit dhe Kulturës*” zëvendësohet me “*Ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën*”

Neni 12

Në Kreun VIII Titulli ndryshohet si më poshtë :

“MARRËDHËNIET KONTRAKTUALE NË VEPRIMTARITË E ARTIT DHE TË KULTURËS”

Neni 13

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“*Neni 34*

Marrëdhëniet financiare me artistët

Marrëdhëniet financiare për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike me artistin jashtë sistemit të institucioneve publike të artit dhe kulturës rregullohen me kontratën e lidhur mes artistit dhe institucionit publik financues nëpërmjet negocimit.”.

SHPJEGIM: Për sa i përket aspektit të cilësisë artistike (honorar) me artistë nga jashtë sistemit, ky tagër dhe negocim u është lënë palëve me negocim, kjo në respekt dhe vlerësim të figurës, personalitetit dhe meritokracisë, bazuar në ofertën e tregut dhe profesionalitetit artistik të artistit.

Neni 14

Shfuqizime

1. Numri “34” në pikën 1 të nenit 35 “Dispozita Kalimtare të fundit” shfuqizohet.
2. Aktet që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E ARTIT.

Projektligji parashikon se, me zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria përgjegjëse e artit dhe kulturës, njësitë e qeverisjes vendore dhe organet publike të artit dhe kulturës të parashikuara në ligjin e artit dhe kulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË
HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektakt është hartuar nga Ministria e Kulturës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
BUXHETORE

Ky projektligj nuk parashikon efekte financiare.

MINISTRI
MIRELA KUMBARO BURXHI

